




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-0/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-846/13</u>
Dep.	Prot No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>12-03-2013</u>
Nr. pages	Date
	<u>12-03-2013</u>
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.02.2012, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-536/12, për z. Sllobodan Petroviç, zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal në Qeverinë e Republikës së Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapar sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë drejtuar në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK–03-536/12, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Sllobodan Petroviç, zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Ku është dyshuar se mund të ketë gjendje të konfliktit të interesit pasi që ushtron edhe pozitën e anëtarit të bordit drejtues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Gjat zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjat kohës së ushtrimit të funksionit publik si zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal në Qeverinë e Republikës së Kosovës, është i angazhuar edhe në një tjetër detyrë, si anëtar i bordit drejtues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 01.06.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, e kemi pritur afatin ligjor, dhe e kemi kontaktuar zyrtarin lartë z. S Petroviç, për të vërtetuar se e ka marrë njoftimin e dërguar nga AKK-ja, dhe kemi kërkuar të takohemi dhe ti bisedojmë rreth çështjes së ngritur, mirëpo zyrtari në fjalë nuk është lajmëruar, kemi kontaktuar kabinetin e tij, dhe na është thënë se zv.Kryeministeri z.Petroviç nuk gjendet në punë pasi që është në vizitë jashtë shtetit, edhe pas disa ditësh kam kontaktuar me kabinetin e ministrit për të pyetur për kthimin e z. Petroviç dhe për të na aranzhuar një takim me të, mirëpo na është thënë se z.Petroviç është shumë i zënë, dhe në momentin ma të shpejt të mundshëm do ju kontaktojmë.

Pas gjithë angazhimit për tu takuar me z.Petroviç, dhe pas njoftimit të bërë me shkrim, dhe pas zbatimit të procedurave për mbledhjen e informatave të nevojshme për të vërtetuar gjendjen e konfliktit të interesit konstatojmë se: mandati i anëtareve të bordit drejtues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit është skaduar.

Andaj në bazë gjendjes reale dhe të gjitha fakteve dhe informatave lidhur me rastin konsiderojmë se nuk ka elemente për të vazhduar me hetimet e mëtutjeshme lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pasi që zyrtarit të lartë z.Sillobodan Petroviç, i ka skaduar mandati në funksionin e anëtarit të bordit drejtues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

